3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk

paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor e refuzon Ofertën.

Nëse Autoriteti Kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë Operatori Ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

11. Paraqitja e Ofertave

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, Operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. ___.

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA - ----- d/m/v, në orën-----” .

12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nëse autoriteti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

13. Ofertat me vonesë

Autoriteti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i Prokurimit Elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu

edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "**MODIFIKIM OFERTE**" ose "**TËRHEQJE OFERTE**".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

15. Hapja e Ofertave Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

16. Konfidencialiteti Autoriteti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

17. Sqarimi i ofertave 1. Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

18. Përgjegjshmëria e ofertave 1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit .

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik 1. Për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret, për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).

20. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1}/O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmax k1$$

Vmaxk1 _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti Kontraktor përdor një nga kriteret vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.
3. Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve arithmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët .

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për

datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sçarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllongarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve: “Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tiranë”, për 12 muaj

Nr.	Artikulli	Specifikime	Njesia
1	Alkool etilik	Reagent analitik me pastërti ~ 96 % reagent. I lëngët, pa ngjyrë me aromë karakteristike të alkoolit. Emri sipas IUPAC: Ethanol , Formula Kimike: C ₂ H ₆ O	Lit
2	Amphotericine B	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
3	Aniline	C ₆ H ₇ N ~ 99.8%	Lit
4	Anti Coli	Antiserum, Tipi 1	Flakon
5	Anti Coli	Antiserum, Tipi 2	Flakon
6	Anti HCV	Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin cilesor te antitropave te Hep C ne serum, plazem ose gjak.	Teste (Cope)
7	Anti Salmonela	Polivalente	Flakon
8	Anti Salmonela	O9	Flakon
9	Antigen Brucella melitensis	Plus Kontroll pozitiv	Kuti
10	Antigen Brucella abortus	Plus Kontroll pozitiv	Kuti
11	Antigen Paratyphi A	Somatic AO	Flakon
12	Antigen Paratyphi A	Flagjelar AH	Flakon
13	Antigen Paratyphi B	Somatic BO	Flakon

14	Antigen Paratyphi B	Flagjelar BH	Flakon
15	Antigen Salmonela	Typhi O	Flakon
16	Antigen Salmonela	Typhi H	Flakon
17	ASLO kit	Bufer + kontrolle	Kuti
18	Acid fosforik	Acid, i lëngët, pa ngjyrë dhe pa aromë. Emri sipas IUPAC: Phosphoric acid Formula Kimike: H ₃ PO ₄ . Shishe qelqi e errët, paketim 1 litër	Lit
19	Acid acetik glacial	Acid Acetik anhidrik me Formule Kimike: C ₂ H ₄ O ₂ , Pure, Shishe qelqi e errët, paketim 1 litër	Lit
20	Acid sulfurik	Acid i lëngët pa ngjyrë ose ngjyrë të lehtë të verdhë. Me aromë të fortë shpuese. Emri sipas IUPAC: Sulfuric acid. Formula: H ₂ SO ₄ , shishe qelqi e errët, në paketim 1 litër	Lit
21	Acid klorhidrik	HCl, 0.1 N, shishe rezistente ndaj vetive gerryese te acidit klorhidrik, në paketim 1 litër	Lit
22	Acid klorhidrik	Muratic acid. Reagent analitik ~ 38%. Acid i lëngët, pa ngjyrë dhe me aromë të fortë shpuese. Emri sipas IUPAC: Hydrochloric acid Formula Kimike: HCl. Shishe qelqi e errët, paketim 1 litër	Lit
23	Acetat amoni	NH ₄ C ₂ H ₃ O ₂ , pure,	Gram
24	Acid oksalik dihidrat	Pluhur i bardhë, kristalin, pa aromë. Formula Kimike: H ₂ C ₂ O ₄ •2H ₂ O	Gram
25	Augumentin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
26	Amikacin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
27	Amoxiclav	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
28	Ampiciline	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
29	Bacitracin	Përdoret si test diferencues për mikroorganizmat. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon

30	Bactrine/ Trimethoprim+Sulphamethoxazole	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
31	Baird-Parker Agar Base	Terren i gatshem pluhur i perdorur per izolimin dhe numerimin e Staphylococci ne ushqime dhe materiale te tjera	Kg
32	Bile Esculin Agar	Pluhur i perdorur ne pregatitjen e terreneve per te bere izolimin, diferencimin dhe identifikimin e supozuar te Streptokokut	Gram
33	Blood agar base	teren baze per pregatitjen e pjatave agar-gjak	Kg
34	Brilant Green Bile Salt Broth 2%	pluhur i perdorur ne pregatitjen e terreneve per te konfirmuar pranine e mikroorganizmave coliform ne uje dhe ushqime..	Kg
35	Brucine	Pure, Pluhur me ngjyrë të bardhë. Shishe qelqi e errët. Emri sipas IUPAC: 10, 11- Dimethoxystrychnine, 2,3-dimethoxystrychnidin-10-one Formula Kimike: C ₂₃ H ₂₆ N ₂ O ₄	Gram
36	Caspofungin	Antimykotik, 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
37	Chloramphenicol	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura.	Flakon
38	Ceclorr\Cefaclor	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
39	Chromogenic Coliform Agar	Pluhur qe perdoret ne zbulimin e Escherichia coli dhe Coliformeve ne mostrat e ujit, per diagnozen hidrike, perfundimtare.	Kg
40	Cefepime	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
41	Ceftazidim	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
42	Ceftraxion	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
43	Cefuroxim	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
44	Ciprofloxacin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
45	Clarithromycin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon

46	Clean Test / ose ekuivalente	Per matjen e shkalles se pastertise	Cope
47	Clotrimazole	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
48	Clyndomicine	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
49	DPD1	Tableta për matjen e klorit të lirë me limit dedektimi 0.01 – 6 mg/l. Emri sipas IUPAC: N, N – diethyl – p – phenylenediamine. Formula Kimike: C ₁₀ H ₁₆ N ₂	Tableta
50	Doxacycline	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
51	E.C. Broth	Escherichia Coli Broth, Terren i gatshëm i përdorur në përgatitjen e terreneve që identifikojnë mikroorganizmat në ujë.	Kg
52	Econazoli	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
53	EDTA (Trilon B)	Pluhur i përbërë nga kristale pa ngjyrë. Ethylenediaminetetraacetic acid	Gram
		disodium salt dihydrate	
		Formula Kimike: C ₁₀ H ₁₄ N ₂ Na ₂ O ₈ •2H ₂ O	
54	Escherichia Coli	polyvalent O, 1 Flakon 3 ml	Flakon
55	Escherichia Coli	OK (enteropatogjene), 1 Flakon 3 ml, 055,0119,0125ac,0127,0128ab.	Flakon
56	Erythromicin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
57	EY Tellurite Enrichment	tretesire e përdorur në përgatitjen e terrenit Baird-Parker Agar Base	Lit
58	Fluconazole	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
59	Food System / ose ekuivalente	Per numerimin e mikroorganizmave patogjene në mostrat ushqimore	Cope

60	Fuksinë bazike	Reagent analitik me Formule Kimike: $C_{19}H_{17}N_3 \cdot HCl$	Gram
61	Gentamicin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.	Flakon
62	Gonorreha	Rapid test/Test i shpejtë për identifikimin e antigenit Gonorrhëa. 1 kuti me 25 teste. Ne permbajtje kasete, reagentet, tamponet dhe konenieret plastik per to.	Kuti
63	Gram Stain Colours	Seti i ngjyrimet te gramit, per identifikimin e mikroorganizmave	Kuti
64	HbsAg	Kasete ,Rapid test/Test I shpejte imunokromatografik per percaktimin e antigenit siperfaqesor te hepatitit B ne serum ose plazma. .	Teste (Cope)
65	HIV1&HIV2	Kasete ,Rapid test/Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin e antittrupavete HIV1&HIV2 ne gjak dhe ne serum.	Teste (Cope)
66	Hidroksid amoni	Reagent analitik i pregatitur nga amoniaku i tretur në ujë. Lëng pa ngjyrë me aromë shpuese. Emri sipas IUPAC: Ammonium hydroxide. Formula Kimike: NH_4OH , shishe e errët e cila siguron mbrojtje nga drita	Lit
67	Hidroksilamin klorhidrat	Hydroxylamine Hydrochloride, $NH_2OH \cdot HCl$, i gjendur dhe me emrin: Hydroxylamine hydrochloride, shishe qelqi e errët	Gram
68	Inipenem	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
69	Itraconazole	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
70	Isavuconazole	1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
71	Jodur kaliumi	Potassium Iodide, rapid test per percaktimin e jodurit te kaliumit ne kripe	Flakon
72	Jodur kaliumi	Reagent analitik me pastërti $\geq 99\%$. Pluhur i bardhë, pa aromë. Emri sipas IUPAC: Potassium iodide Formula Kimike: KI	Gram
73	Jodat kaliumi	Potassium Iodate, rapid test per percaktimin e jodatit te kaliumit ne kripe	Flakon
74	Kanamycin	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
75	Ketokonazole	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon

76	K.F. Streptococcus broth	Per identifikimin e Streptococcus Faecal ne mostrat e ujit	Kg
77	Kite fece gjak okult	test rapid	Teste
78	Kite fece Helicobakter Pylori	test rapid	Teste
79	Kite Cri ptosporidium Fece	test rapid	Teste
80	Kite Entamoeba Fece Test	test rapid	Teste
81	Kite Toxoplasmose	test rapid	Teste
82	Klamidia	Rapid test, 1 kuti me 30 cope, Ne permbajtje kasete, reagentet, tamponet dhe konenieret plastik per to.	Kuti
83	Kontroll polivalent	pozitive per Antigenet febrile te Salmoeles	Flakon
84	Klorur natriumi	NaCl, pure, paketim që siguron mbrojtje nga drita	Gram
85	Klorur Magnezi	MgCl ₂ x 6H ₂ O, shishe e errët	Gram
86	Lactophenol cotton blue	ngjyrues	Flakon/Shishe
87	LDC (Lysine Decarboxylase)	I perdorur per diagnozen diferenciale dhe perfundimtare te baktereve hidrike	Gram
88	Macconkey Agar	Terren i gatshem i perdorur ne izolimin e baktereve gram - (negative)	Kg
89	Mera test / ose ekuivalente	Per zbulimin e antibiotikeve ne mostrat ushqimore	Cope
90	Meropenem	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
91	Myconasole	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon

92	Micafungin	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
93	Molibdat amoni	$(\text{NH}_4)_6\text{Mo}_7\text{O}_{24} \cdot 4\text{H}_2\text{O}$, pure, shishe e errët e cila siguron mbrojtje nga drita	Gram
94	Myller Hinton Agar	Pluhur, ngjyre bezhe i perdorur ne pergatitjen e terreneve mikrobiologjike, tretet mire ne uje	Kg
95	Negram	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
96	Neomycin	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
97	Nitrofurantoin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
98	Nessler	Paketim 1 litër; shishe rezistente e cila te siguroje mbrojtje te integritetit te reagentit	Lit
99	NEDA, N-(1-Naphtyl)ethylenediaminedihydrochloride	$\text{C}_{12}\text{H}_{14}\text{N}_2 \cdot 2\text{HCL}$, Pure	Gram
100	Nystatin	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
101	Ox19	Antigen Ox19 per Rikecia	Flakon
102	Oxacilin	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
103	o-fenantrolina	1,10-Phenanthroline, $\text{C}_{12}\text{H}_8\text{N}_2 \cdot \text{H}_2\text{O}$ Pure, shishe qelqi e errët	Gram
104	o-Tolidine	o-Tolidine 0.1 % (1,6 M), shishe e errët qelqi.	Lit
105	Penicilline	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e bakteve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
106	Polypeptone	UNIVERSAL, pluhur me ngjyre bezhe, i perdorur ne pergatitjen e terreneve mikrobiologjike	Kg
107	Rose Bengal	test + kontroll	Kuti
108	Sabouraud Dextrose Agar	Terren i gatshem, pluhur i perdorur per kultivimin e majave dhe mykut	Kg

109	Sabouraud Dextrose Broth	Terren i gatshem, pluhur i perdorur per kultivimin e majave dhe mykut	Gram
110	Salmonella	polyvalent	Flakon
		A-S+ Vi, 1 Flakon me 3 ml	
111	Salmonella	0:9, group D, 1 Flakon me 3 ml	Flakon
112	Salmonella	antiserum 0 te grupit D, 1 Flakon me 3 ml	Flakon
113	Shigele Flexner (6)	serum	Flakon
114	Shigele Boydi	serum	Flakon
115	Shigele Polivalente	Serum antigenic i cili vërteton shigelen (e ndan nga te tjerat)	Flakon
116	Shigele Sonei	serum	Flakon
117	Staphylococcus test	Rapid test per specifikimin e Staphylococcus, paketimi 1 kuti/2 flakon	Kuti
118	Streptococcus test	Rapid test per identifikimin dhe diferencimin e Streptococcus, strep grouping rapid latex test kit	Kuti
119	Sulfat Zinku	ZnSO ₄ •7H ₂ O v.p. , paketimi 1 kuti/ 1 kg	Kg
120	Sulfat Zinku	ZnSO ₄ •7H ₂ O, Solucion standard 0,05 M, shishe e errët e cila siguron mbrojtje nga drita	Lit
121	Solucion standard amoniaku	Paketimi 50 ml, me përqëndrim 1mg/l	Cope
122	Solucion standard nitriti	Paketimi 50 ml, me përqëndrim 1mg/l	Cope
123	Solucion standard nitratesh	Paketimi 50 ml, me përqëndrim 1mg/l	Cope

124	Solucion standard hekuri total	Paketimi 50 ml, me përqëndrim 1mg/l	Cope
125	Solucion Standard sulfatesh	Paketimi 50 ml, me përqëndrim 1mg/l	Cope
126	Sulfanilamid	$C_6H_8N_2O_2S$; shishe e errët e cila siguron mbrojtje nga drita; pure	Gram
127	Syphilis	Kasete , Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e syphilis .	Teste (Cope)
128	Tetracyclin	1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
129	Teste te oksidazes	teste te perdorura per te bere diferencimin midis mikroorganizmave	Pako
130	Tobramicine	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
131	Tuba me xhel	Tuba me xhel per marrjen e gjakut, tuba 5 ml pa llogaritur xhelin ose 7 ml duke llogaritur xhelin	Cope
132	Urosistem	per identifikimin e mikroorganizmave ne urine	Cope
133	Urea Agar Base (Christensen)	pluhur qe perdoret per percaktimin e baktereve enterike	Gram
134	Vankomycin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve. 1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.	Flakon
135	Voriconazole	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon
136	Xylenol orange	$C_{31}H_{32}N_2O_{13}S$, pure, paketim që siguron mbrojtje nga drita	Gram

- **Afati i skadencës për kitet dhe reagentet:** Data e skadencës në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës,
- **Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull**

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:**

Artikulli	Pershkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorezimit
Alkool etilik	Reagent analitik me pastërti ~ 96 % reagent. I lëngët, pa ngjyrë me aromë karakteristike të alkoolit. Emri sipas IUPAC: Ethanol , Formula Kimike: C ₂ H ₆ O	Lit	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Amphotericine B	Antimykotik. 1 Flakon permban 50 disqe te ngopura	Flakon	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Aniline	C ₆ H ₇ N ~ 99.8%	Lit	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Anti Coli	Antiserum, Tipi 1	Flakon	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Anti Coli	Antiserum, Tipi 2	Flakon	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Anti HCV	Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin cilesor te antitropave te Hep C ne serum, plazem ose gjak.	Teste (Cope)	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Anti Salmonela	Polivalente	Flakon	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Anti Salmonela	O9	Flakon	Pranë magazines se NJVKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Antigen Brucella melitensis	Plus Kontroll pozitiv	Kuti	Pranë magazines se	12 muaj nga

			NJKSH Tiranë	nenskrimi i MK
Antigen Brucella abortus	Plus Kontroll pozitiv	Kuti	Pranë magazines se NJKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
Antigen Paratyphi A	Somatic AO	Flakon	Pranë magazines se NJKSH Tiranë	12 muaj nga nenskrimi i MK
